



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr. 2676, datë 14.04. 2016

Për

“Miratimin e mbylljes dhe rezultateve të procesit të filluar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 2664, datë 14.01.2016 për monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtare
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtare
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtare

dhe sekretare Znj.Sara Recu, në mbledhjen e datës 14.04.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e mbylljes dhe rezultateve të procesit të monitorimit të efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular, filluar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 2664, datë 14.01.2016 për “ Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, date 06.11.2014””

BAZA LIGJORE

1. Shkronja a), b) dhe ll) të nenit 8, nenet 34, 36, 45, 53, 55, 56 dhe 57, pika 1 dhe 3 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Kodi i Procedurave Administrative (**KPrA**);
3. Dokumenti “Analizë e tregut të telefonisë së lëvizshme:
 - Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike telefonike individuale të lëvizshme;
 - Tregu me pakicë i shërbimeve celulare”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2522, datë 6.11.2014 (**Analiza e Tregut Celular 2014**);
4. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2664, datë 14.01.2016 për “Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”” (**VKD nr. 2664/2016**);
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2506, datë 30.10.2014 (**Rregullore e Brendshme**).

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

- Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare të çështjes sipas rendit të ditës, të paraqitur në mbështetje të nenit 12 të Rregullores së Brendshme, për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit Drejtues, e cila përmban:

1. Aktin administrativ VKD nr. 2664/2016, nga ku buron çështja për shqyrtim;
 2. Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim dhe aktin e propozuar për miratim (**Relacioni**);
 3. Dokumentacionin bashkëshoqërues (prova, referenca rregullatore/ligjore /administrative);
 4. Projekt-akti (Vendimi i Këshillit Drejtues) i propozuar për miratim (**Projekt-VKD**);
- dhe:

- Nga diskutimet mbi çështjen gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues, nëpërmjet analizës së fakteve, provave dhe propozimit mbi bazën ligjore referuese dhe praktikën më të mira rregullatore të vendeve të BE e Rajonit, si dhe rekomandimeve të BEREC,

V Ë R E N :

I. Nga pikëpamja procedurale:

1. Çështja për shqyrtim sipas rendit të ditës i paraqitet Këshillit Drejtues në zbatim të dispozitivit të VKD nr. 2664/2016, ku është vendosur :

- *AKEP të vazhdojë monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net në tregun celular, përfshirë efektet e zbatimit të detyrimit nga data 1.01.2016 për përdoruesit me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).*
- *Të pezullohet fillimi i zbatimit të efekteve të masave rregulluese të vendosura nga AKEP për vlerat e tarifave të terminimit për periudhën 1.01.2016 e në vazhdim të përcaktuar në tabelat në pikat 2/a dhe 4/a të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”.*
- *Për efekt të llogaritjes dhe faturimit të pagesave të ndërsjellta midis sipërmarrësve lidhur me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare nga data 1.01.2016, sipërmarrësit të përdorin tarifën e përcaktuar nga AKEP për periudhën 1.07.2015 deri 31.12.2015, në Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015.*
- *Afati i pezullimit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, është deri në datën e marrjes së vendimit përfundimtar, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë pas datës së marrjes së këtij vendimi.*

2. Struktura përgjegjëse në AKEP për:

- monitorimin e vazhdueshëm të tregut të komunikimeve elektronike, përcaktimin dhe analizën e tregjeve përkatëse dhe rregullimin e tarifave, kompetenca këto të AKEP të parashikuara në shkronjat a), b) dhe ll) të nenit 8, nenet 34, 36, 45, 53,55, 56 dhe 57 të ligjit nr. 9918;

si dhe në rastin konkret për:

- monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular, filluar me VKD nr. 2664/2016;

ka përmbushur detyrën e ngarkuar në vijim të pikës 1 të VKD nr. 2664/2016, duke bërë monitorimin e efekteve të zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net dhe off-net nëpërmjet:

- Monitorimit on-line të planeve tarifore të katër operatorëve celularë;
- Inspektimit të operatorëve celularë në periudhën Janar-Shkurt 2016 për zbatimin e detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net;
- Monitorimit të ecurisë së trafikut të operatorëve celularë sipas të dhënave mujore të dërguara periodikisht nga operatorët celularë;
- Ecurisë së treguesve të tregut celular dhe financiarë të kompanive celulare në vitin 2015 krahasuar me vitet e mëparshme.

1. Në kuadër të veprimeve procedurale administrative dhe rregullatore, në funksion të kryerjes së një procesi sa më transparent, të paanshëm dhe profesional, AKEP me Urdhërin e Brendshëm nr.1674, datë 18.01.2016, ngriti një Grup Inspektimi për "*Kontrollin e zbatimit nga operatorët celularë të masave rregulluese të percaktuara nga AKEP me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 2542, date 13.03.2015 për "Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014".*

Grupi i Inspektimit (GI) kreu kontrolle tek të katër operatorët celularë në periudhën 26.01.2016-17.02.2016, duke u fokusuar në:

- *praktikat e komunikimeve të brendshme të sipërmarrësit për garantamin e zbatimit të detyrimeve të Vendimeve dhe Sqarimeve të AKEP për zbatimin e detyrimit;*
- *kontratat e lidhura/rinovuara pas datës 1.07.2015, veçanarisht Aneksin e tarifave të aplikuar;*
- *njoftimet e kryera përdoruesve me kontrata standarde dhe specifike për ndryshimet planeve tarifore më 1.01.2016;*
- *planet tarifore me kontrata të personalizuar/specifike, përfshirë ato me CUG dhe kontratat respective;*
- *zbatimin në sistemin e tarifimit/billing-ut, si dhe faturime për përdoruesit pas dates 1.07.2015;*
- *zbatimin në pikat e shitjes të sipermarresit (me zgjedhje nga Grupi i Inspektimit dhe pa njoftim paraprak për cilën/cilat pika shitje).*

Duke patur parasysh dhe njerën nga arsyet thelbësore mbi të cilën u ngrit dhe nevoja e kryerjes së procesit të monitorimit sipas VKD nr. 2664/2016, puna e GI u fokusua veçanarisht në klientët me kontratë me plane tarifore specifike (që kanë pasur dhe CUG), pasi për përdoruesit e tjerë me kontratë dhe parapagim tarifat janë të publikuara në faqen e Internetit të secilit operator (monitorimi i të cilave mund të bëhet on-line).

3. Brenda afatit të kryerjes së detyrës sa më sipër, struktura përgjegjëse ka nxjerrë një raport analitik përmbledhës mbi rezultatet e procesit të monitorimit të efekteve të mos-diskriminimit të tarifave *on-net/off-net* dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular, filluar me VKD nr. 2664/2016, të shoqëruar dhe me propozimin përkatës për periudhën në vijim lidhur me nivelin e tarifës së terminimit të thirrjeve të operatorëve celularë Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom në rrjetin e operatorit celular Plus Communication.

4. Këshilli Drejtues i AKEP, merr në shqyrtim çështjen në mbështetje të statusit të tij ligjor sipas pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, kompetencave dhe procedurës së përcaktuar në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe rregulloren e brendshme, brenda afatit të vendosur në pikën 4 të dispozitivit të VKD nr. 2664/2016.

II. Nga pikpamja e ligjshmërisë:

1. Objekti i trajtimit të çështjes së filluar me VKD nr.2664/2016 për monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave *on-net/off-net* dhe ecurinë e skemës për reduktimin e

asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregut celular është i bazuar ligjërisht pasi:

- 1.1 Masat rregullatore të vendosura nga AKEP sipas vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 06.11.2014” (**VKD nr. 2542/2015**) si dhe ato në shqyrtim nëpërmjet këtij vendimi lidhur me:
- a) skemën e reduktimit të asimetrisë për tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin e operatorit celular Plus Communication deri në nivelin e tarifave simetrike me ato të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albscom në nivelin 1.48 lek/min., të aplikuar prej tyre që prej datës 01.12.2014;
 - b) zbatimin e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën që aplikohet nga operatorët celularë ndaj përdoruesit për ofrimin e shërbimit të thirrjeve brenda rrjetit (*on-net*) me ato drejt rrjeteve të tjera celulare (*off-net*),

përbëjnë disa ndryshime plotësuese ndaj këtyre masave rregullatore të përcaktuara në dokumentin “Analiza e Tregut Celular 2014” për këtë qëllim dhe jo qëndrim të ri të organit rregullator ndaj këtyre detyrimeve.

- 1.2 Sipas nenit 34 të ligjit nr. 9918 përcaktohet se: “*AKEP-i kryen, në interval të rregullta, por jo më pak se një herë në dy vjet, analizën e tregjeve përkatëse, të identifikuar sipas parashikimeve të këtij ligji. Pas përcaktimit nëse një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ose nëse ekziston faktikisht një konkurrencë efektive, atëherë detyrimet anulohen, mbahen, shtohen ose vendosen në përfundim të analizës së tregut*”.

Në përputhje me këtë përcaktim ligjor, AKEP në analizën e tregut përkatës sipas dokumentit **Analiza e Tregut Celular 2014**, ka përcaktuar se:

- a) Katër operatorët celularë (Vodafone Albania, AMC (aktualisht Telekom Albania), Albscom dhe Plus Communication) përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre celulare;
- b) Në lidhje me detyrimet për Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në kuadër të vendosjes së masave rregulluese sipas nenit 36 të ligjit nr. 9918, që të katër operatorët të vazhdojnë të kenë detyrimet e përcaktuara në analizën e tregut celular 2012 dhe më pas:
 - Mosdiskriminimi
 - Transparenca
 - Dhënie Akses dhe Interkoneksion dhe përdorim i përbashkët i faciliteteve të rrjetit
 - Kontroll i tarifave dhe sistemi i mbajtjes së llogarive

Respektivisht detyrime këto të parashikuara në nenet, 39, 40, 41, 42, 44 dhe 45 të ligjit nr. 9918.

Duke patur parasysh objektin në shqyrtim, theksojmë **vendosjen e detyrimit për rregullimin e tarifave në tregun përkatës, konkretisht të tarifës në nivel shumice të terminimit të thirrjeve në rrjetet e secilit nga të katër operatorët celularë të cituar më sipër, i parashikuar në nenin 45 të këtij ligji.**

Përcaktimi i katër operatorëve celularë me FNT sipas analizës së tregut celular 2014 dhe detyrimi i vendosur nga AKEP në kuadër të masave rregulluese për rregullimin e **tarifës në nivel shumice të terminimit të thirrjeve në rrjetet e secilit nga të katër operatorët celularë**, nuk kanë qenë objekt rivlerësimi as në vendimmarrjen e AKEP sipas VKD nr.

2542/2015, VKD nr. 2664/2016 dhe nuk janë as në këtë vendimmarje sipas këtij akti administrativ rregullator. Ato nuk janë anuluar apo ndryshuar. **Ajo që është vendosur në këto akte ka qenë vetëm plotësimi i skemës sipas metodologjisë së zbatuar për rregullimin e tarifës së terminimit të thirrjeve në nivel shumice në rrjetin e operatorit celular Plus Communication, në përputhje me nenin 56 dhe 57 të ligjit nr. 9918.**

1.2 Neni 56 i ligjit nr. 9918 përcakton se:

“ 1. Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, është arritur në përfundimin se për tregun përkatës të aksesit dhe interkoneksionit (tregu i shumicës) nuk ka konkurrencë efektive, që nënkupton se në treg nga sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg janë zbatuar tarifa të larta të paarsyeshme, ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë dhe nëse masat e parashikuara në nenet 39 deri 43 të këtij ligji nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosi detyrimin për rregullimin e tarifave në këtë treg përkatës, sipas nenit 57 të këtij ligji duke nxjerrë vendimin për rregullimin e tarifave”

Analiza e tregut celular 2014, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2522, datë 6.11.2014, arriti në përfundimet e mësipër cituara, të cilat të ndodhura në klauzolat e kësaj dispozite ligjore çuan në marrjen e vendimit nga AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e të katër operatorëve celularë (trugu i shumicës)

duke përcaktuar në këtë dokument edhe metodologjinë e rregullimit sipas nenit 57 të ligjit nr. 9918 dhe skemën e zbatimit të reduktimit të nivelit asimetrik të tyre deri në arritjen e një tarife simetrike 1.48 lek/min., referuar tarifës mesatare të vendeve të BE-së (pika 2b. neni 57).

Konkretisht u vendos:

- a) Tarifa e terminimit e Vodafone, AMC (Telekom) dhe Eagle Moble (Albtelecom) të reduktohet më datë 1.12.2014 në nivelin 1.48 lek/minutë, që përbën mesataren benchmark për vendet anëtare candidate në BE që kanë aplikuar metodologjinë LRIC të pastër në 2013 (të përcaktuar nga AKEP në dokumentin e miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr.2435, datë 13.03.2014);
- b) Tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication të qëndrojë 6.52 lek/minutë deri në një vendim tjetër të AKEP.

Gjithashtu analiza e tregut celular 2014 evidentoi situatën problematike të krijuar nga sjellja e operatorëve celularë lidhur me diskriminimin e tarifave *on-net/off-net* duke çuar AKEP në marrjen e vendimit për vendosjen e disa masave detyruese rregulluse të karakterit normativ kuadër, për mos-diskriminimin në tarifa me pakicë (*on-net* dhe *off-net*).

Nisur nga ankimet administrative të depozituara në AKEP nga të katër operatorët celularë Vodafone Albania, AMC(Telecom Albania), Albtelecom dhe Plus Communication, ku palët ankimuese paraqisnin respektivisht (Vodafone, AMC dhe Albtelecom) kundërshtime mbi nivelin e tarifës asimetrike dhe skemën e zbatimit të tij si dhe të vendosjes së masave rregulluse për mos-diskriminimin në tarifa me pakicë (*on-net* dhe *off net*) (Vodafone Albania, AMC, Albtelecom dhe Plus Communication), AKEP rishqyrtoi skemën e zbatimit të këtyre detyrimeve dhe me vendim nr. 2542/2015, vendosi plotësimin e kësaj skeme me afatet përkatëse për reduktimin e nivelit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (treg shumice), si dhe të afateve për zbatimin e skemës së detyrimit me masa rregulluse të karakterit normative kuadër për mos-diskriminimin e tarifave (treg pakice).

Sipas këtij vendimi operatorit Plus Communication iu plotësua skema e reduktimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij celular (treg shumice) deri në barazimin e saj me tarifën simetrike të vendosur për zbatim nga tre operatorët e tjerë celularë me datë 01.12.2014, duke ruajtur një nivel asimetrie të vendosur nga organi rregullator si stimul me qëllim përballimin e konkurrencës me operatorët ekzistues në momentin e hyrjes së tij në treg. Stimuli i asimetrisë së kësaj tarife për operatorin Plus Communication si hyrës i ri në treg, u vendos nga AKEP në referencë me praktikën e vendeve të BE-së, rekomandimeve të KE dhe BEREC, si dhe ato të zbatuara për operatoret e tjerë celularë në momentin e hyrjes në treg. Kjo skemë përcaktonte reduktimin e tarifës me faza duke marrë në konsideratë edhe faktin që ky stimul është i përkohshëm brenda një kufiri kohor të arsyeshëm sipas rekomandimeve të KE dhe BEREC. Në marrjen e këtij vendimi AKEP mori në konsideratë edhe fazat e zbatimit të masave rregulluese për mos-diskriminim të tarifave on-net/off-net sipas skemës së përcaktuar.

1.3. Sipas skemës së zbatimit të detyrimit për rregullimin e tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë (treg shumice) dhe mos-diskriminimin në tarifën *on-net/off-net* (treg pakise), vendosur nga AKEP me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2522, datë 6.11.2014 për miratimin e dokumentit “Analiza e tregut celular 2014”, plotësuar me VKD nr. 2542/2015:

- a) tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin e operatorit celular Plus Communication më datë 01.01.2016 duhej të arrihte dhe zbatohet në nivelin 1.48 lek/min, simetrike me ato të tre operatorëve të tjerë Vodafone Albania, Telecom Albania dhe Albtelecom;
- b) më datë 01.01.2016 fillonte zbatimi i fazës së fundit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net që lidhet me zbatimin e tij edhe për përdoruesit e tjerë me kontratë.

AKEP, në monitorim dhe administrim të vazhdueshëm të efekteve të zbatimit të masave rregulluese sipas skemës së vendosur për rregullimin e situatës problematike të krijuar për shkak të diskriminim në tarifën *on-net/off-net* (tregu me pakicë), si dhe të reduktimit të nivelit të asimetrisë së tarifës së terminimit të thirrjeve (tregu me shumicë) në rrjetin e operatorit Plus Communication, gjykoi se fillimi i zbatimit të kësaj faze të detyrimit për mos-diskriminim në tarifën *on-net/off-net*, pritej të sillte ndryshime të tjera në strukturën e trafikut, për të cilat duhej të kishte një panoramë dhe vlerësim më të thelluar të tërë efekteve që do të derivojnë për pasojë, si dhe të krijonte bindjen e konsoliduar se faktorët me ndikim në shkaqet dhe nevojën për të cilën ishte zbatuar skema e stimulit të asimetrisë së kësaj tarife për operatorin Plus Communication, nuk do të ishin më pengesë për aplikim e tarifës simetrike me operatorët e tjerë celularë.

Në këto rrethana AKEP, me VKD nr. 2664/2016 vendosi fillimin e një procesi monitorimi të thelluar analitik të efekteve të administruara që nga fillimi i zbatimit të skemës së reduktimit të asimetrisë së tarifës në fjalë dhe të procesit të mos-diskriminimit në tarifën *on-net/off-net*.

2. Përfundimisht, veprimet e kryera nga AKEP për sa më sipër, që lidhen me skemat e zbatimit të detyrimeve të vendosura në kuadër të masave rregulluese, janë kryer bazuar në analizën e tregut celular 2014 dhe gjenden plotësisht të bazuara ligjërisht si në aspektin procedural ashtu dhe në atë thelbësor të tyre.

III. Konteksti ankimues i aktit administrativ 2664/2016 nga operatorët celularë

VKD nr. 2664/2016 u ankimua administrativisht nga Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, të cilat kërkuan revokimin e plotë të këtij vendimi. AKEP me Vendimet nr.2565, 2566 dhe 2567, datë 11.02.2016 shqyrtoi ankimet administrative të sipërmarrësve Albtelecom sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a. duke lenë në fuqi Vendimin Nr. 2664, datë 14.01.2016, dhe duke sqaruar ndër të tjera se: *Vendimi nr. 2664, date 14.01.2016, ka natyrë të përkohëshme pezulluese, dhe argumentat e tre sipërmarrësve në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin Plus Communication sh.a duke filluar nga 1.01.2016, do të trajtohen në Vendimin e AKEP, i cili sipas pikave 1 dhe 4 të VKD nr. 2664, datë 14.01.2016, do të marrë në konsideratë dhe rezultatet e monitorimit të efekteve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net në tregun celular dhe do të merret nga AKEP brenda 90 ditëve nga data 14.01.2016.*

IV. Rezultatet e procesit të monitorimit sipas VKD 2664/2016

1. Nga monitorimi on-line i planeve tarifore të operatorëve celularë dhe ndryshimeve të tyre në zbatim të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net rezulton se të katër operatorët celularë kanë kryer ndryshimet e nevojshme duke filluar nga data 1.07.2015, duke zbatuar dhe udhëzimet e AKEP të dërguara në fillim të muajit Korrik 2015. Procesi ka ecur në mënyrë të kënaqshme dhe të katër operatorët celularë janë treguar bëshkëpunues për të eliminuar në kohën e duhur disa raste sporadike dhe të kufizuara të vena re nga AKEP apo nga vet operatorët në tarifën on-net/off-net.
2. Zbatim i detyrimeve të mos-diskriminimit sollën ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:
 - përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celularë apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
 - reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promovionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.
3. Ndryshimet e kryera nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje “pa limit” brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktikisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdoruesit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celularë). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë, që trajtohen më poshtë.
4. Të katër sipërmarrsit janë në zbatim të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifën on-net/off-net të vendosura nga AKEP me VKD nr.2522-2526, datë 6.11.2014, të ndryshuara

me VKD nr.2542, datë 13.03.2015, dhe sqarimet e dërguara nga AKEP me shkresën Nr.1177/7 Prot., datë 9.07.2015. Përfundimet e verifikimeve u përmbledhën në Aktet e Inspektimit Nr.32-35, datë 26.02.2016.

5. AKEP ka vazhduar monitorimin e efekteve të zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net edhe në trafikun e operatorëve celularë dhe pagesat për terminimin e thirrjeve midis operatorëve. Ky monitorim është kryer periodikisht nga AKEP bazuar në të dhënat e dërguara çdo muaj nga operatorët celularë për trafikun e përdoruesve të tyre. Trafiku i gjeneruar nga rrjetet celulare gjatë vitit 2015 arriti në rreth 7.4 miliard minuta, e cila përbën një rritje të vogël me rreth 1.5 % në krahasim me vitin 2014. Megjithëse sasia totale e thirrjeve nuk pati ndryshim të madh, llojet e ndryshme të thirrjeve patën ndryshime të ndjeshme. Në vitin 2015 thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 16% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare (off-net) u rritën me 2.4 herë në krahasim me vitin 2014. Nga të dhënat vihet re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 33% në Shkurt 2016. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 64% në Shkurt 2015.
6. Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në Korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Në dy muajt e parë të vitit 2016, që përkon me afatin e zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit edhe për përdoruesit me kontrata specifike, pesha e thirrjeve off-net është rritur me 3 pikë përqindje, ndërsa pesha e thirrjeve on-net është zvogëluar me 2 pikë përqindje.
7. Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97% v 3% në Janar 2014 në 75% v 25% në Shkurt 2016. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha, nga 96% v 4% në Janar 2014 në 65% v 35% në Shkurt 2016.
8. Rritja e ndjeshme e sasisë së trafikut off-net dhe reduktimet e tarifave të terminimit kanë çuar dhe në ndryshime të ndjeshme të trafikut neto (hyrës minus dalës midis operatorëve celularë) dhe të ardhurave/pagesave neto midis operatorëve celularë për trafikun e terminuar në rrjetet e tyre, të cilat kanë rritur aftësitë konkurruese të dy operatorëve më të vegjël dhe të rinj në treg, Plus dhe Albtelecom (EM).
9. AKEP në përfundim të rezultateve të monitorimit të vazhdueshëm të cituara dhe me sipër si dhe të argumentave të operatorëve celularë për asimetrinë, të dhëna gjatë ankimeve për Vendimin nr.2664, datë 14.01.2016 dhe shkresat e dërguara nga të katër operatorët celularë, praktikave më të mira në BE (rekomandimet e BEREC dhe KE), kushtet e tregut Shqiptar, vlerëson që:

- a) skema e rregullimit të tarifave për tarifën e terminimit në rrjetin Plus Communication nga 1 Prill 2016 e në vijim të jetë 1.48 lek.minutë, në simetri me tarifën që zbatohen edhe nga operatorët e tjerë celularë Vodafone Albania, Telecom dhe Albtelecom;
- b) skema e masave rregulluese për mos-diskriminim në tarifën *on-net/off net* është e suksesshme duke vijuar me uljen e efekteve diskriminuese dhe nxitjen e një konkurrence efektive dhe me përfitim për përdoruesit.

PËR KËTË ARSYE:

Këshilli Drejtues, në mbështetje të Pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 dhe Rregullores së Brendshme të AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë mbylljen e procesit të monitorimit dhe rezultatet e raportit përmbledhës të paraqitur nga struktura përgjegjëse, në zbatim të detyrës së përcaktuar në VKD 2664/2016, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Skema e rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë (treg shumice) në zbatim të detyrimit të rregullimit të këtyre tarifave të vendosur nga AKEP sipas analizës së tregut celular 2014, nga data 01.04.2016 të vijojë me tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus Communication në nivelin 1.48 lek/ minutë, në simetri me tarifën e tjera të tre operatorëve celularë Vodafone Albania, Telecom Albania dhe Albtelecom.
3. Ky vendim të publikohet në faqen web të AKEP www.akep.al.
4. Vendimi hyn në fuqi datën e publikimit të tij në faqen web të AKEP www.akep.al

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

- | | | |
|-------------------|-----------------|----------------|
| 1. Alban | Karapici | Anëtar |
| 2. Anila | Denaj | Anëtare |
| 3. Ketrin | Topçiu | Anëtare |
| 4. Klarina | Allushi | Anëtare |